37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39                      Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40                      Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41                      Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42                      Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43                      Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.



### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës       |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përshkrimi i nenit                        | Neni. Nr. |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha              | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.                                                                                                                                                                                                                                                                            |
|                                           | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë: <b>gjuhët në përdorim zyrtarë</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Siguria e ekzekutimit                     | 10.1      | Shume e sigurisë së ekzekutimit është <b>10 % e vlerës së kontratës, ose 11449,94 me validitet deri 30.10.2022</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2      | Shuma minimale e sigurimit do të jetë:<br>(a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat];<br>(b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat];<br>(c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat];<br>(d) dëmtim personal ose vdekje:<br>(i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat]<br>(ii) të personave të tjerë: [shëno shumat] |
| Programi                                  | 12.1      | <b>Planin për Menaxhimin e Kontratës.</b><br><b>Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|                                           | 12.2      | Periudha për Programin e azhurnuar është <b>2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Fillimi i punëve                          | 17.1      | <b>Data e fillimit do të jetë : 30.06.2022</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|                                           | 17.2      | <b>Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës 30.09.2022</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Dëmet e likuiduara                        | 19.1      | <b>Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë.</b><br><br><b>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.</b>                                                                                                                                                                                                                                                  |
|                                           | 20.1      | [Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk është nevojitet].                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Inspektimi dhe testimi                    | 22.1      | <b>Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni i Pranimit të punëve – shërbimeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues.</b><br><br><b>Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia,</b>                  |


|                                                    |      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|----------------------------------------------------|------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                    |      | <p>nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve-shërbimeve të Autoritetit Kontraktues.</p> <p>Menagjer I projektit nga ana e AK është: Sabahat Hasani</p> <p>Menagjer mbikqyres I kontrates nga ana e AK është Behar Brenolli</p> <p>Menagjer I projektit nga ana e OE është: Ylli Qafleshi</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| pagesa                                             | 24.1 | Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit- situacioneve të aprovuara nga ana e Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit deri në 70 % të projektit, pagesa do të kryhet në afate sa më të shkurtë kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës, kurse pjesa tjetër e kontratës do të realizohet pas perfundimit të punimeve të percjellura me raport nga ana e menaxherit të kontrates dhe raportit nga ana e komisionit të pranimit teknik të projektit                                                                                                                                                                                 |
| Parapagimi                                         | 26.1 | Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Mbajtja e Parasë                                   | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: <i>[shëno përqindjen]</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Shkaqet për kompensim                              | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>[shëno numrin]</i> ditë pas nënshkrimit të kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Përgjegjësia mbi Defektet                          | 34.5 | Periodha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm. Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti të lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vleren e përgjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës                 | 39.1 | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve               | 42.2 | Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | <p>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të</p> |

|  |  |                                                                                                      |
|--|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  |  | kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi. |
|--|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------|


Niki - 60

Garazhet Akry


| PARAMASA DHE PARALLOGARIA:<br>Ndërtimi i garazhdave për automjetet e QKMF- Dragash |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                |        |             |             |
|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|--------|-------------|-------------|
| PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR NDËRTIMIN E GARAZHDAVE                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                |        |             |             |
| A                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                |        |             |             |
| Nr                                                                                 | Përshkrimi i pozicionit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Njësia         | Sasla  | Çmimi ( € ) | Shuma ( € ) |
| 1                                                                                  | PUNËT PREGADITORE                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |                |        |             |             |
| 1.1                                                                                | Ingjizimi i parcelës vendosja e pikave gjeodezike të terenit dhe objektit. Llog në komplet                                                                                                                                                                                                                                                | komplet        | 1.00   | 50.00 €     | 50.00 €     |
| 1.2                                                                                | Sigurimi i terenit, vendosja e rrethojave në vendpunishje si dhe furnizimi me rryme. Llog në komplet                                                                                                                                                                                                                                      | komplet        | 1.00   | 50.00 €     | 50.00 €     |
| 1.3                                                                                | Identifikimi i rrjetit nentoksoz të ujësjesit, kanalizimit rrjeteve eventuale elektrike dhe në raste nevojë dislokimi i tyre në thellësi me të madhe se gërmimet e tokës, ku të gjitha instalimet nentoksore duhet të jenë në thellësi të sigurt. Llog në komplet                                                                         | komplet        | 1.00   | 50.00 €     | 50.00 €     |
| 1.4                                                                                | Furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjesit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndërtimi të kantierit, vendosja e kontajnerëve për inxhinierët mbikëqyrës dhe punëtorët. Llog në komplet                                                                                                                       | komplet        | 1.00   | 100.00 €    | 100.00 €    |
| 1.5                                                                                | Furnizimi, transportimi dhe montimi i tavolinës së armiruesve. Llog në m                                                                                                                                                                                                                                                                  | m <sup>1</sup> | 12.00  | 10.00 €     | 120.00 €    |
| 1.6                                                                                | Pas përfundimit të punimeve të gjitha ndërtimet e përkohshme duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i objektit si dhe terreni rreth objektit. Llog në komplet                                                                                                                                                                            | komplet        | 1.00   | 50.00 €     | 50.00 €     |
| Gjithsej:                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                |        |             | 420.00 €    |
| 2                                                                                  | PUNËT DEMOLIMIT, PASTRIMIT, TOKËSORE DHE MBUSHJA                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                |        |             |             |
| 2.1                                                                                | Pastrimi i mbeturinave të ngurta dhe materialeve të ndryshme që gjenden në vendin ku do të ndërtohet objekti. Materialet largohen në deponi me të afër legale deri në 12km. Llog në m2                                                                                                                                                    | m <sup>2</sup> | 480.00 | 2.00 €      | 960.00 €    |
| 2.2                                                                                | Demolimi me kujdes të shtuar i pllakës nga beton armeja, me makineri ndërtimore, me mjete për thyerje me çekana apo vegla dhe kompresore adekuate, prerje të betonit. Materialet e demoluara largohen në deponi me të afër legale deri në 12km. Llog në m2                                                                                | m <sup>2</sup> | 200.00 | 2.00 €      | 400.00 €    |
| 2.3                                                                                | Demolimi me kujdes të shtuar i murit të vjetër së bashku me themelet nga beton armeja, me makineri ndërtimore, me mjete për thyerje me çekana apo vegla dhe kompresore adekuate, prerje të betonit. Materialet e demoluara largohen në deponi me të afër legale deri në 12km. Llog në m2                                                  | m <sup>3</sup> | 31.20  | 10.00 €     | 312.00 €    |
| 2.4                                                                                | Demolimi me kujdes të shtuar i murit ekzistues së bashku me themelet nga beton armeja, me makineri ndërtimore, me mjete për thyerje me çekana apo vegla dhe kompresore adekuate, prerje të betonit. Materialet e demoluara largohen në deponi me të afër legale deri në 12km. Llog në m2                                                  | m <sup>3</sup> | 28.50  | 10.00 €     | 285.00 €    |
| 2.5                                                                                | Demolimi me kujdes të shtuar i pushtave nga betoni së bashku me gypat, me dimensione të ndryshme. Materialet e demoluara largohen në deponi me të afër legale deri në 10km. Llog në copë                                                                                                                                                  | copë           | 4.00   | 15.00 €     | 60.00 €     |
| 2.6                                                                                | Gërmimi i gjerë i dheut bregor në thellësi deri 3.00m me makinë në sipërfaqen e objektit. Në llogari të merret edhe transporti i dheut të tepërt deri në deponi te qytetit 12km. Llog në m3                                                                                                                                               | m <sup>3</sup> | 567.00 | 4.00 €      | 2,268.00 €  |
| 2.7                                                                                | Gërmimi i gjerë i dheut në thellësi 20-40cm për themelet me makinë në sipërfaqen e objektit. Hapja e themeleve sipas projektit. Në llogari të merret edhe transporti i dheut të tepërt deri në deponi te qytetit. Llog në m3                                                                                                              | m <sup>3</sup> | 144.00 | 3.00 €      | 432.00 €    |
| 2.8                                                                                | Hapja dhe gërmimi i kanalit për gypat të kanalizimit në dheut e kategorisë III-V në gjersin e kanalit b=0.60m dhe thellësi deri 2.0 m, si dhe prerja e një pjese të asfaltit me gjatësi b=1.0m dhe kthimin e rrugës në gjendjen e mëparshme. Në llogari të merret edhe transporti i dheut të tepërt deri në deponi te qytetit. Llog në m3 | m <sup>3</sup> | 138.00 | 3.00 €      | 414.00 €    |




|            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                |        |         |             |
|------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|--------|---------|-------------|
| 2.9        | Gërmimi dhe hapja e pusetave kontrolluese. Në llogarit të merret edhe transporti i dheut të tepërt deri në deponi të qytetit 12km. Llog në m3                                                                                                                                                                                                                                                                                    | m <sup>3</sup> | 14.94  | 3.00 €  | 44.82 €     |
| 2.10       | Ngjeshja dhe planifikimi i dheut në tërë sipërfaqen ku do të punohen themelet, me ngjeshje. Llog në m2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | m <sup>2</sup> | 360.00 | 0.20 €  | 72.00 €     |
| 2.11       | Furnizimi, transportimi, planifikimi, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit me trashësi të shtresës d = 10 - 15 cm me precizitet ± 3 cm, nën themele dhe nën pllaken e dyshemesc. Ngjeshja bëhet me cilindër vibrues 12- 24 t, derisa të arrihet moduli i ngjeshjes N = 7000 KN/m <sup>2</sup> . Llog në m3                                                                                                                          | m <sup>3</sup> | 54.00  | 5.00 €  | 270.00 €    |
| 2.12       | Furnizimi me material, transporti dhe mbushja e hapësirës për rreth mureve të themeleve me zhavor për mbushje duke përfshirë shtrirjen dhe ngjeshjen me mekanizëm në shtresa prej 20-30 cm deri në arrijten e kompaktësisë së nevojshme. Llog në m3                                                                                                                                                                              | m <sup>3</sup> | 72.00  | 5.00 €  | 360.00 €    |
| 2.13       | Furnizimi dhe montimi i gypit të drenazhit Ø100mm prapa murit. Llog në m                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | m <sup>1</sup> | 54.00  | 1.10 €  | 59.40 €     |
| 2.14       | Furnizimi, transporti dhe mbushja me zhavor 16-64mm në hapsirat mbrapa murit gjerësi 30cm, për drenazhim përreth murit të objektit. Llog në m3                                                                                                                                                                                                                                                                                   | m <sup>3</sup> | 151.20 | 5.00 €  | 756.00 €    |
| 2.15       | Furnizimi, transporti, shtrirja, planifikimi dhe ngjeshja e rërës nën dhe mbi gypa me trashësi t=10cm. Llog në m3                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | m <sup>3</sup> | 72.00  | 1.00 €  | 72.00 €     |
| 2.16       | Mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar në shtresa si dhe ngjeshjen e nevojshme. Llog në m3                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | m <sup>3</sup> | 10.80  | 1.00 €  | 10.80 €     |
| Gjithsej : |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                |        |         | 6,776.02 €  |
| 3          | PUNËT E BETONIT                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                |        |         |             |
| 3.1        | Furnizimi, transportimi dhe betonimi i shtresës së betonit të varfër me C12/15 me trashësi d = 6-7 cm nën pllakën e themeleve për hidroizolim horizontal të objektit, ku më parë është bërë mbushja adekuatë me zhavor në trashësi d = 10 - 15 cm. Llog në m3                                                                                                                                                                    | m <sup>3</sup> | 15.12  | 40.00 € | 604.80 €    |
| 3.2        | Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve të objekteve dhe mureve nga betoni i armuar C 25/30 si dhe ngjeshja e tijë gjatë tërë kohës së hüdhes së betonit në vepër. Betonimi do të bëhet vetëm pasi të jetë punuar dhe vendosur pahla dhe tërë armatura e projektuar. Llog në m3                                                                                                                                           | m <sup>3</sup> | 66.00  | 70.00 € | 4,620.00 €  |
| 3.3        | Furnizimi, transporti dhe betonimi i pllakes së dyshemesc/pllakes mbi themele , trashësi t=20cm, nga betoni i armuar C 25/30, me pahl dhe skele të nevojshme. Llog në m3                                                                                                                                                                                                                                                         | m <sup>3</sup> | 36.85  | 70.00 € | 2,579.50 €  |
| 3.4        | Furnizimi, transporti dhe betonimi i shtyllave dhe trareve, nga betoni i armuar C 25/30, dimenzionet të punohen sipas spifikacioneve, me pahl dhe skele të nevojshme. Llog në m3                                                                                                                                                                                                                                                 | m <sup>3</sup> | 16.43  | 70.00 € | 1,150.10 €  |
| 3.5        | Furnizimi, transporti dhe betonimi i pllakes së katit , trashësi t=20cm, nga betoni i armuar C 25/30, me pahl dhe skele të nevojshme. Llog në m3                                                                                                                                                                                                                                                                                 | m <sup>3</sup> | 40.98  | 70.00 € | 2,868.60 €  |
| 3.6        | Furnizimi, transporti, betonimi dhe punimi i shkallëve të jashtme për ngjitje në katën e objektit si dhe shkallëve të hyrjes me pjerrin për persona me nevoja të veçanta nga betoni i armuar C 25/30 si dhe ngjeshja e tijë gjatë tërë kohës së hüdhes së betonit në vepër. Betonimi do të bëhet vetëm pasi të jetë punuar dhe vendosur pahla dhe tërë armatura e projektuar, dimenzionet të punohen sipas projektit. Llog në m3 | m <sup>3</sup> | 10.11  | 70.00 € | 707.70 €    |
| 3.7        | Furnizimi, transporti dhe betonimi i mureve të objekteve nga betoni i armuar C 25/30, me pahl dhe skele të nevojshme. Llog në m3                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | m <sup>3</sup> | 65.88  | 70.00 € | 4,611.60 €  |
| 3.8        | Furnizimi, transporti dhe betonimi i murit për nivelizim e oborrit duke përfshirë edhe themelin nga betoni i armuar C 25/30, me trashësi trashësi t=20cm, h=deri 120cm, me pahl dhe skele të nevojshme. Llog në m3                                                                                                                                                                                                               | m <sup>3</sup> | 16.45  | 70.00 € | 1,151.50 €  |
| Gjithsej : |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                |        |         | 18,293.80 € |
| 4          | PUNËT E ARMIMIT                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                |        |         |             |




|           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |       |          |            |             |
|-----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|----------|------------|-------------|
| 4.1       | Çeliku për armaturë do të jetë i brinjëzuar përveç nëse ipen indikacione tjera nga organi mbikqyrës. Çeliku për armaturë do të aplikohet në përputhje të plotë me normat ENV 10080 si dhe të posedon me karakteristikat që vijnë: Vlera karakteristike e kufirit të rrjedhjes (yield strength characteristic value) $f_{yk}=500 \text{ N/mm}^2$ . Madhësitë e diametrit të përputhen me vlerat nominale sipas ENV 10080. Furnizimi, prerja, lakimi dhe montimi i shufrave të armaturave duhet të bëhet sipas formave të paraqitura në detalet teknike si dhe të verifikohen në vendpunishte. Çeliku për armaturë do të aplikohet në përputhje të plotë me normat ENV 10080. Klasa e duktilitetit (ductility class) B-e lartë (high ductility) B 500 B. Armaturë nga $\Phi 8$ mm deri $\Phi 20$ mm dhe rrjetë Q335,Q524 sipas specifikacionit. | kg    | 19736.00 | 1.10 €     | 21,709.60 € |
